Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES
(SUPER-EKSPERTIZË)

Ismail Rushiti	12.01.2024	22.01.2024	2023/1013
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.12.2023, OE " KIGA " SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1013, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "N.P.T. "Gresa-Commerce & MBB Construction" lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME PELET" me nr. të prokurimit: "70030-23-8606-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Pergjithshem- Peje. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës:furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 180,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi,
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatese te legjislacionit sekondar te KRPP-se. Te pakenaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues te datës 04.12.2023 të (AK) Spitali i Përgjithshem Pejë ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME PELET me nr. te prokurimit: 70030-23- 8606-1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 70030-023-018-111, ne afatin ligjor konform nenit 109 le LPP-së, ushtrojme kete ankese prane OSHP-se:

(pas tri kërkesave per rishqyrtim ky tre here AK e ka kthyer ne rivlerësim kete aktivitet të prokurimit dhe ne fund prap ka vazhduar me shkelje te LPP-së)

Për shkak se AK- Spitali i Përgjithshem Pejë :
A.Ne mënyre te kundërligjshme ka rekomanduar per kontrate nje grup të operatoreve ekonomik (GOE) i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.
B.Ne menyre te kunderligjeshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

Sqarojmë ne mënyrë të detajuar:
Autoriteti Kontraktues Spitali i Përqjithshem Pejë me datën 16.11.2023 ka Publikuar njoftimin B58 ku ka rekomanduar per kontrate grupin e operatoreve ekonomik: N.T.P."GRESA - COMMERCE"; "MBB Construction" SH.P.K. i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT. Me poshtë po i paraqesim provat qe OE i rekomanduar për kontrate është i pa përgjegjshëm dhe është dashur te eliminohet neve kemi parashtruaar kerkese per rishqyrtim pranë AK-se ma date 01.12.2023 per ta njoftuar AK-ne me shkeljet dhe ti korrigjoj ato shkejle por AK as qe ka dashurta merr mundin qe te na shqyrtoj pretendimet tona dhe as qe i ka përmend pretendimet tona ne vendim dhe as qe e ka arsyetuar refuzimin duke vepruar ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se nenin 108/A pika 9 ku thuhet se: Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim.

Me poshte e keni vendimin e AK-se ku AK kunderligjeshem i ka Hedhur pretendimet tona pasi qe me LPP nuk ka hedhje por AK mundet ose ti refuzoj si te pa bazuara pretendimet tona ose ti pranoj si te bazuara e jo ti hedh si te pa bazuara sepse AK nuk ka baze ligjore per këto veprime:

V E N D I M

HUDHËN TË PA BAZUARA, kërkesat për ri-shqyrtim të parashtruara nga Operatorët Ekonomik : " KIGA" SHPK & "KIGA" SH.P.K "Sllatine e madhe, Për Aktivitetin e Prokurimit Furnizim me pelet per nevoja te spitalit te pergjithshem me Nr. të Prok: 70030-23-8606-1-1-1.

- **MBETET NË FUQI VENDIMI MBI REZULTATIN E PROKURIMIT PAS RI-VLERSIMIT I datës:29.11.2023.**
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

ARSYETIM

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.
Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Gëzim Ademaj
Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit

Ncve prap po i përsërisim pretendimet tona edhe pranë OSHP-se. A. Tani i keni pretendimet tona lidhur me OE te rekomanduar per kontrate ku me fakte i kemi treguar AK-se qe ai OE eshte i pe pergjegjeshem si me poshtë:
1.AK ne NJK dhe DT ka parapare qe: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional: Kerkesa 2. Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN - ISO 9001 2015 VEREJTJE CERTIFIKATATENATYRESSËNJEJTË (-ISO 9001) ME TE AVANCUARA PRANOHEN Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2. Kopje e certijikatës EN —ISO 9001 2015 valide
Ky OE ka ofruar nje kopje te një certifikate për ndërtim te objekteve banesore dhe jo sipas kërkesës se AK-se dhe nuk ka kurrfar certifikate EN - ISO 9001 2015 ne vend qe ta eliminoj, AK ne rastin konkret kete OE e ka rekomanduar per kontrate edhe pse eshte i pa pergjegjeshem.

2. AK ne NJK dhe DT ka parapare qe: Kërkesal mbi mundësitë teknikc dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional:

Kerkesa 3. O.E OFERTUES DUHET TË DORËZOJË ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST, KJO ANALIZË DUHET TË JETË NGA NJËINSTITUCION1LICENCUAR. DUHET TE POSEDOICERTIFIKA TË TEKNIKE N+A2

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia
3. ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST NGA NJËINSTITUCION1 LICENCUAR- DUHET TE POSEDOICERTIFIKATË TEKNIKE N+A2 ORIGJINAL OSE KOPJE E NOTERIZUAR. Ky OE nuk e ka ofruar CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2 ORIGJINAL OSE KOPJE E NOTERIZUAR, por ka marre nga interneti certifikata dhe analiza te peletit dhe e ka bashkangjitur ne oferte, pra këto certifikata nuk janë ne emër te asnjërit prej operatoreve qe kane aplikuar ne këtë tender AK ne vend qe ta eliminoj kete OE ne rastin konkret kete OE e ka rekomanduar per kontrate edhe pse eshte i pa pergjegjeshem.

3.Ky GOE është i pa përgjegjshëm pasi qe nuk e ka plotësuar formularin e tenderit siç duhet gjithashtu edhe nuk e ka dorëzuar listën e çmimeve dhe menjëherë është dashur te eliminohet sipas A02_Udhezues Nr-001_2023 për prokurimin publik konform nenit 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve pika 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së:

Lista e çmimeve nuk është plotësuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Gjithashtu paramasa eshte pjese e formularit të tenderit, që patjeter duhet te plotesohet sic duhet:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Ndërsa OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar.
AK është dashur menjëherë ta eliminoj këtë GOE e jo ta shpërblej me kontratë.
B. Tani i kemi pretendimet tona ku AK kunderligjeshem na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit si me poshtë:
1.AK ne mënyrë te kunderligjeshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyen si me poshte: dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:O/erta e juaj është e papërgjegjshëme dhe ka statuesin e ofertës së eliminuar : Oferta e kompanisë tuaj: Te kërkesa III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional,deshmitë tuaja cilat i ke prezentuar nuk e mbrrinë vleren 270.000,OOeuro.
Oferta e juaj nuk ka dëshmi të mjaftueshme,nuk është në PAJTIM me kërkesat e dosjes.

Pra na habit fakti se si AK per neve ne oferte nuk i sheh deshmite qe i kemi ofruar ne dokumentacion kurse Operatoret tjere nuk i kane deshmite dhe AK i shpall te pergjegjeshem, kjo ndodh vetem tek kjo AK pasi qe edhe heren e pare AK e ka shpall nje OE te pa pergjegjeshem dhe pas kerkeses tone per rishqyrtim e ka eliminuar por prap po i ben gabimet e njejta duke rekomanduar OE qe nuk i plotesojne kerkesat e AK-se.

Sa per eliminimin tone po ja bejme me dije AK-se se vetem anetari i grupit Liki Group ka dorezuar listen per furnizim me pelet ne vlere prej 436,029.75 € qe e tejkalon kerkesen e AKse prej 270,00.00€ pa i marre edhe listat e anetareve te tjere. Me poshte po e bashkangjsim listen:

LIKI GROUP

LIKI GROUP
Lista e Shtijes te gjitha me lende djegese PELET
lunikgjata46@gmail.com
Adresa : Zona Industriale
Nr. 810051946
Tel : +383 45 222 663

Nr.	Viti	Kompania		Vlera e Kontratës
1	02.12.2022	Artmotion Sh.p.k fatura me nr 1-87	€	9,699.60
2	19.12.2022	KIGA SH.P.K fatura me nr 1-93	€	20.669,47
3	14.10.2022	RIT KOSOVA fatura me nr 1-78	€	24,001.20
4	12.01.2023	NTP HARIS fatura me nr 1-99	€	34,998.80
5	01.06.2023	Bytyqi OIL- fatura me nr 1-98	€	6,758.80
6	01.10.2023	Komuna e Prishtines nr i Prok 616-22-1817-1-2-5	€	52,000.00
7	14.03.2023	N.P.T Haris	€	71,001.00
8	20.03.2023	ELIS SHPK	€	60,529.00
9	22.07.2022	NTP GRESA COMERC fatura me nr 1-68,1-69-1-73	€	52,402.62
10	24.09.2022	N.P.T Haris	€	36,001.80
11	20.12.2022	Shoqata Carita Umbria	€	11,898.53
12	21.12.2022	ELIS SHPK fatura nr 1-97	€	8,359.12
13	24.10.2022	NTSH ZHAKI	€	4,800.24
14	25.10.2022	Ndermarrja e re Fabrika e Amortizerav fatura nr 1-80	€	12,480.62
15	27.10.2022	Ejupi SH.P.K fatura nr 1-81	€	14,099.82
16	21.11.2022	NP Qendra SH.A fatura nr 1-85	€	9,801.08
17	02.12.2022	Klan Kosova shpk fatura nr 1-88	€	9,699.60
18	19.12.2022	ELIS SHPK fatura 1-94	€	9,499.00
19	20.12.2022	ELIS SHPK fatura nr 1-95	€	7,998.92
		Vlera totale (€)	€	436,029.75

SH.P.K. LIKI GROUP PRISHTINË

Gjithashtu ne kërkesën e dyte për rishqyrtim i kemi dorëzuar edhe qarkullimet bankare për secilin operator qe e kemi shënuar ne listën e mësipërme dhe me përshkrimin e pagesave te faturave sipas listës se mesiperme.

2.Pike e dytë qe na ka eliminuar AK tani për here te trete pasi vlerësohet ky aktivitet është kinse neve nuk i kemi dorëzuar analizat Dështmia 3. ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A- TEST NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR- DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2 ORIGJINAL OSE KOPJE E NOTERIZUAR Por neve e kemi dorëzuar komplet analizën ne emër te partnerit tone Liki Group shpk si me poshtë:

Sara & Meti

DAK
TESTIM
L 086

KORPORATA FITOSANITARE
"SARA & METI" Sh.p.k.
Rr. Kamer Loshi Nr. 24, Prishtinë,
Tel: 044/213-795, 044/ 406-717

Raport testimi

Nr.897/23

Laboratori Analitik, Bujqësorë dhe i Ushqimit

1. Mostra për analizë — Mostër e Peletit të drurit
2. Analizat e kërkuara — Analizat fiziko-kimike (analizat e kualitetit)
3. Porositësi i analizave — Liki group.SH.P.K.Milloshevë NF.811588732
4. Marrja e mostrës — Mostra është sjellë në laborator nga pala

Rezultatet e analizave:

Parametri i analizuar	Njësia matëse	Vlerat referente	Rezultatet e fituara	Metoda e zbatuar
Diametri	mm	6±1 - 8 ±1	6.12	EN 14961-2
Gjatësia	mm	3,15 < L < 40	24.36	EN 14961-2
Dendësia	kg/dm³	600 ≤ BD ≤ 750	692	EN 14961-2
Qëndrueshmëria mekanike	W - %	≥ 98.0 – 97.5	98.75	prEN 15210-1
Lagështia	w - %	< 10	6.19	ISO 712:1998
Vlera kalorifike	kwh/kg	≥ 4.6	5.22	EN 14961-2
Hiri	w - %	≤ 0.7 - ≤ 1.2	0.65	ISO 5984:1978
Temperatura e peletit	°C	≤ 40	24.6	Metodë interne laboratorike
Përmbajtja e pluhurit	w - %	< 1.0	0.12	EN 14961-1
Sulfuri - S	w - %	≤ 0.03- ≤ 0.05	0.006	EPA metoda 375.3
Klori -Cl	w - %	≤ 0.04 - ≤ 0.05	0.021	EPA metoda 325.3
Azoti - N	w - %	≤ 0.3 - ≤ 0.5	0.27	ISO 5983:1997
Plumbi -Pb	mg/kg	≤ 10	0.020	ISO 6869:2000
Kadmiumi - Cd	mg/kg	≤ 0.5	0,013	ISO 6869:2000
Arseni - As	mg/kg	≤ 1	ND	ISO 6869:2000
Kromi - Cr	mg/kg	≤ 10	0.05	ISO 6869:2000
Bakri - Cu	mg/kg	≤ 10	1.4	ISO 6869:2000

Vërejtje: Rezultatet vlejnë vetëm për këtë mostër. Ky raport nuk lejohet të fotokopjohet.

KORPORATA - CORPORATION SARA&METI Sh.p.k.

Sara & Meti

DAK
TESTIM
L 086

Merkuri - Hg	mg/kg	≤ 0.1	ND	ISO 6869:2000
Nikeli - Ni	mg/kg	≤ 10	0.008	ISO 6869:2000
Zinku - Zn	mg/kg	≤ 100	12.7	ISO 6869:2000

ND= Nën Nivelin e Detektimit

Prishtinë
Datë: 04.09.2023

KORPORATA - CORPORATION SARA&METI Sh.p.k. PRISHTINË

zv. Menaxheri i cilësisë
Dr. sc. Fadil Musa

Neve e kemi dorëzuar analizën komplet sipas kërkesës se dosjes dhe në emër tonë kurse OE-te tjerë këto analiza i kanë marre nga intemeti dhe nuk i kane ne emër te tyre dhe AK ju ka pranuar kurse neve na ka eliminuar këhi po vërehet se AK haptas po na diskriminon dhe haptas bën shkelje ligjore edhe pse janë te vetëdijshëm se duhet ta respektojnë ligjin ne përpikëri.

Është për tu habitur fakti se si ka mundësi qe është hera e trete ku AK i shpërblen me kontrate OE-te e pa përgjegjshëm ndërsa neve qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat dhe kemi dorëzuar çmimin me te lire na eliminon ndoshta me qellim AK për ta prolonguar procesin dhe ka ndonjë interes tjetër pasi qe gati periudha e dimrit është kryer dhe zyrtari i prokurimit te AK dëshiron qe te zhvilloj procedura te negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë me një OE te preferuar te tije, edhe pse dy herët e kaluara kërkesat tona per rishqyrtim i ka aprovuara si te bazuara.

Siç po shihet me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet nie jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhejodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Si dhe ne piken 2 thuhet:
Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mëmjrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te nje ose më shume operatoreve ekonomik.
AK nuk i ka vlerësuar ne mënyrë te barabarte te gjithë OE-te te cilët kane aplikuar ne këtë aktivitet te prokurimit.

AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, ku neve kemi ofertuar mc ofertuar me Tender të përgjegjshëm dhe me Çmimin më te ulët.

Ndersa OE i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me tender te pa pergjegjeshem. Pra neve jemi OE me Çmimin më te ulët që kenii dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjifha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP qe ta detyroj AK-ne qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi lidhur me kete lloj te aktivitetit te prokurimit dhe te nxjerr:

VENDIM

I.APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupit te Operatorëve Ekonomik: KIGA SH.P.K ; LIKI GROUP SH.P.K.. lidhur me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME PELET me nr. te prokurimit: 70030-23-8606- 1 -1-1 dhe Nr. i brendshëm: 70030-023-018-111 te iniciuar nga AK- Spitali i Përgjithshëm Pejë.

II.ANULOHET njoftimi B-58 per dhenie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME PELET me nr. te prokurimit: 70030-23-8606-1 -1 -1 dhe Nr. i brendshëm: 70030-023-018-111 te iniciuar nga AK- Spitali i Përgjithshëm Pejëz dhe lënda kthehet ne Rivleresim dhe pas rivleresimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kerkesa 2. Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2015 VEREJTJE CERTIFIKATAT E NATYRES SË NJEJTË (–ISO 9001) ME TE AVANCUARA PRANOHEN	**Dëshmia 2. Kopje e certifikatës EN – ISO 9001 2015 valide**
Kerkesa 3. O.E OFERTUES DUHET TË DORËZOJË ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST, KJO ANALIZË DUHET TË JETË NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR. DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2	**Dëshmia 3. ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR-DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2ORIGJINAL OSE KOPJE E NOTERIZUAR**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar [6]
SPITALI I PËRGJITHSHËM PEJË

Nr. i Prokurimit:	**70030-23-8606-1-1-1**
Nr. i Prokurimit: (mbrendshem)	

Titulli: "FURNIZIM ME PELET"

I/e nderuar(a) **'Grup i Operatorëve Ekonomik KIGA SH.P.K.; LIKI GROUP SH.P.K. Sllatine e Madhe 12000 Fushe Kosove**Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,siç citohet në vazhdim "LPP "*Tenderi juaj*është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:*Oferta e juaj* është e papërgjegjshëme dhe ka statusin e ofertës së eliminuar : Oferta e kompanisë tuaj: Te kërkesa **III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional,deshmitë tuaja cilat i ke prezentuar nuk e mbrrinë vleren 270.000,00euro.**
Pika 3.Analiza teknike të PeletitN+A2.
Oferta e juaj nuk ka dëshmi të mjaftueshme,nuk është në PAJTIM me kërkesat e dosjes.
Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Data: 29.11.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP:,
Gëzim Ademaj

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

OE ankues mund të konsiderohet si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES " KIGA SH.P.K."

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Pergjithshem- Peje, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "FURNIZIM ME PELET" me nr. të prokurimit: "70030-23-8606-1-1-1", procedurë e hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 180,000.00 €.

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 14.08.2023, gjithashtu edhe Formulari standard per korrigjimin e gabimeve B54 ne njoftimet e publikuara me datë 14.08.2023.

AK me datë 29.11.2023 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe Letrat Standarde per OE-të.

OE "KIGA SHPK" ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, kundër vendimit të AK-së.

Ndërsa, AK ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 13.12.2023 OE "KIGA SHPK ", ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/1015, për Super-Ekspertizë dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Pergjithshem- Peje me datë 29.11.2023, përmes Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe Lertës standarde, ka njoftuar Operatorët Ekonomik pjesëmarrës për rezultatin e aktivitetit të prokurimit, njëherit edhe parashtruesi i ankesës OE ankues **"**KIGA SH.P.K.", është njoftuar për arsyet e eliminimit nga ky aktivitet i prokurimit. Në vendimin e lartë cekur të AK-së janë dhënë arsyet për eliminimin e OE ankues , ku thuhet se:

"Oferta e kompanisë tuaj: Te kërkesa ***III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional,deshmitë tuaja cilat i ke prezentuar nuk e mbrrinë vleren 270.000,00euro.***
Pika 3.Analiza teknike të PeletitN+A2.
Oferta e juaj nuk ka dëshmi të mjaftueshme,nuk është në PAJTIM me kërkesat e dosjes".

Fillimisht Eksperti shqyrtues sqaron se, sipas paragrafit 9 te nenit 108/A te LPP-se, percaktohet qartë se, "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë

procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".

Gjithashtu, edhe neni 62.2 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton:

"**62.2 Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit.**

Pretendimi ankimor OE ankues: "AK ne mënyrë te kundërligjshëm na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyen si me poshte: Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:Oferta e juaj është e papërgjegjshëme dhe ka statuesin e ofertës së eliminuar : Oferta e kompanisë tuaj: Te kërkesa III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional, deshmitë tuaja cilat i ke prezentuar nuk e mbrrinë vleren 270.000,OOeuro. Oferta e juaj nuk ka dëshmi të mjaftueshme, nuk është në PAJTIM me kërkesat e dosjes. Pra na habit fakti se si AK per neve ne oferte nuk i sheh deshmite qe i kemi ofruar ne dokumentacion kurse Operatoret tjere nuk i kane deshmite dhe AK i shpall te pergjegjeshem, kjo ndodh vetem tek kjo AK pasi qe edhe heren e pare AK e ka shpall nje OE te pa pergjegjeshem dhe pas kerkeses tone per rishqyrtim e ka eliminuar por prap po i ben gabimet e njejta duke rekomanduar OE qe nuk i plotesojne kerkesat e AK-se, si dhe Pretendimi i OE ankues pike e dytë qe na ka eliminuar AK tani për here te trete pasi vlerësohet ky aktivitet është kinse neve nuk i kemi dorëzuar analizat Dëshmia 3. ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR- DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2ORIGJINAL OSE KOPJE E NOTERIZUAR".

Përgjigje Pretendimit ankimor:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik si dhe pretendimit ankimor te OE ankues lidhur me arsyet e eliminimit nga AK, sqaron si në vijim:

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:

Kerkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontrata për furnizime te njejta, te realizuara ne tri vjetet e shkuara (20,21,22) para dates se publikimit te ketij njoftimi per kontrate, në

vlere me se paku; 270000 euro. Ne rast konsorciumi lideri duhet te kete te pakten 60% te vleres se qarkullimit.

<u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u>

Deshmia 1. OE duhet te ofroj deshmi a). Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të ketij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. b). Referencat ose raportet e pranimit te furnizimeve në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive ose raportet e pranimeve te furnizimeve është bërë për një autoritet publik apo privat në, për dëshmi duhet te dorëzohen raportet e pranimeve ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë.
Pas shqyrtimit dhe administrimit të shkresave të lëndës, fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, duke u bazuar në kërkesën e lartë cekur të dosjes së tenderit si arsye për eliminimin e OE ankues nga AK, lidhur me këtë pretendim Eksperti Shqyrtues sqaron si në vijim: Në ofertën e dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K", janë prezantuar lista e kontratave dhe lista e shitjes për lëndët djegëse PELET.

Për ta sqaruar më mirë, nga **OE "KIGA SHPK"** është prezantuar lista me 64 kontrata në vlerë 769,129.39 euro të bashkangjitura me disa referenca për kontratat e përfunduara, ndërsa nga anëtari i këtij grupi-konzorciumi OE "LIKI GROUP SH.P.K", është prezantuar lista e shitjes për lëndët djegëse PELET në vlerë 436,029.75 euro, si dhe me Fatura si dëshmi për realizimin e shitjes së lëndës djegëse PELET.

Megjithatë sqarojmë se, kontratat e prezantuara në këtë listë nga **OE "KIGA SHPK",** kontrata me numër rendor 6,7,41 dhe 64 janë kontrata për furnizime të njejta sipas kërkeses në dosjen e tenderit e të cilat në vlerë totale janë 106,576.91 euro, andaj për këto kontrata ka bashkangjitur vetëm një referencë si dëshmi për furnizime të njejta.

Lidhur me kërkesën në fjalë, Eksperti shqyrtues sqaron se: duke qenë se, AK ka kërkuar që "Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontrata për furnizime të njejta, të realizuara ne tri vjetet e shkuara (20,21,22) para dates se publikimit te ketij njoftimi per kontrate'. Pra sipas kërkesës se lartë cekur në dosjen e tenderit, në kuptim të prokurimit publik: Termi **"njëjtë"** ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a punë të njëjtë (identike) me lëndën e kontratës, prandaj kontratat tejera në ketë listë meqenëse nuk janë kontrata për furnizime të njejta, nuk mund të merret për bazë në llogaritje.

Për më shumë, në lidhje me përkufizimin e termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme" në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, KRPP me datë 09.06.2023, ka dhënë një Opinion i cili është i publikuar tek pyetjet e shpeshta , përkatësisht opinioni me numër 11.

Eksperti shqyrtues, gjithnjë duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, ku thuhet se "*Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontrata për furnizime te njejta, te realizuara ne tri vjetet e*

shkuara (20,21,22) para dates se publikimit te ketij njoftimi per kontrate, në vlere me se paku; 270000 euro. Ne rast konsorciumi lideri duhet te kete te pakten 60% te vleres se qarkullimit", si dhe bazuar në atë që u tha më lartë, edhe për kundër se anëtari i konzorciumit OE "LIKI GROUP SH.P.K", ka prezantuar listën e shitjes për lëndët djegëse PELET në vlerë 436,029.75, **megjithatë konsideroj se, bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, lista e kontratave e prezantuara nga OE "KIGA SHPK", në këtë rast si lider i konzorciumit, nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, rrjedhimisht Grupi i Operatorëve Ekonomik "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K" është i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.**

Ky konstatim mbështetet në faktin se, meqenëse AK në dosjen e tenderit me këtë kërkesë ka përcaktuar pragun se, "**Ne rast konsorciumi lideri duhet te kete te pakten 60% te vleres se qarkullimit**". Ndërsa **OE "KIGA SHPK"**, duke qenë se në këtë aktivitet të prokurimit është përcaktuar si lider i konzorciumit, bazuar në dokumentacionin e prezantuar me ofertë, **nuk ka ofruar dëshmi për kontrata për furnizime të njëjta, të realizuara në tri vjetet e shkuara për të paktën 60% të vlerës së qarkullimit sipas kërkesës së në dosjen e tenderit.**

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

<u>Përgjigje Pretendimit ankimor:</u>

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor të OE ankues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik si dhe pretendimit ankimor te OE ankues lidhur me arsyet e eliminimit nga AK, sqaron si në vijim:

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë:

<u>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:</u>

Kerkesa 3. O.E OFERTUES DUHET TË DORËZOJË ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST, KJO ANALIZË DUHET TË JETË NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR. DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 3. ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR- DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2ORIGJINAL OSE KOPJE E NOTERIZUAR.

Eksperti Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe administrimit të shkresave të lëndës, fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, duke u bazuar në kërkesën e lartë cekur të dosjes së tenderit si arsye për eliminimin e OE ankues nga AK, sqaron se: AK në dosjen e tenderit ka kërkuar **"**O.E OFERTUES DUHET TË DORËZOJË ANALIZËN TEKNIKE TË PELETIT A-TEST, KJO ANALIZË DUHET TË JETË NGA NJË INSTITUCION I LICENCUAR. DUHET TE POSEDOI CERTIFIKATË TEKNIKE N+A2"**,** Ndërsa, në ofertën e dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K" është prezantuar raporti i testimit për analizën teknike .

Sqarim për Panelin Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues marrë parasysh atë që u tha më lartë, pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë nuk janë shqyrtuar fare, për faktin se, **Grupi i Operatorëve Ekonomik "KIGA SH.P.K"; "LIKI GROUP SH.P.K" nuk ka prezantuar fakte dhe provë përkitazi me vertetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi i AK-së, rrjedhimisht është i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit**, me titull: "FURNIZIM ME PELET" me nr. të prokurimit: "70030-23-8606-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali i Pergjithshem- Peje.

Prandaj, **Operatori Ekonomik ankues "KIGA SHPK" mund të konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4.1.26, të LPP-së** i cili përcakton: "*Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*", gjithnjë duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura si dhe duke u bazuar në Njoftimin e OSHP-së të datës 09.02.2023 të publikuar në web faqen e OSHP-së, përkatësisht pika a), ku thuhet se: ***"a) Nëse ankuesi nuk prezanton asnjë fakt apo fakte dhe provë përkitazi me vertetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi, respektivisht akti i atakuar i AK për eliminimin e tij/sajë dhe/ose nuk e argumenton faktin/pohimin bazë, se është i përgjegjshëm për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ushtruar ankesë;".***

Gjithashtu, Eksperti shqyrtues sqaron se:

Paragrafi 2 të nenit 24 të LPP-së përcakton, citojmë:

"**Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".**

Sipas nenit 59 të LPP-së, **ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues.**

Paragrafi 4 i nenit 59 të LPP-së, përcakton si në vijim, citojmë:

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, ***"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".***

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Spitali i Përgjithshëm Pejë
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - “ KIGA " SH.P.K.”